



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

**UDHËZUES
PËR MËSIMIN DHE VLERËSIMIN NË KUSHTET E
SHTËPISË,
PËR LËNDËT PROFESIONALE DHE
MODULET PROFESIONALE
NË ARSIMIN PROFESIONAL**

Tiranë, 23.03.2020

Në zbatim të vendimeve të fundit të qeverisë për ndërprerjen përkohësisht të mësimin në mjediset e shkollave të sistemit arsimor parauniversitar, edhe në Arsimin Profesional (AP) ka vijuar realizimi i mësimin nga mësuesit dhe nxënësit në kushtet e shtëpisë.

Ky Udhëzues ka për qëllim që të ndihmojë drejtuesit e shkollave profesionale, mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve praktike profesionale për mënyrën se si të organizojnë trajtimin online të procesit mësimor dhe si të mundësojnë vlerësimin e nxënësve, në kushtet e shtëpisë, deri në rikthimin e situatës normale të procesit mësimor.

1. Në lidhje me aspektet Administrative të mësimin në kushtet e shtëpisë:

- Drejtoria e shkollës (drejtori dhe/ose nëndrejtori përkatës) është përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e mësimin në kushtet e shtëpisë.
- Të gjitha komunikimet midis drejtuesve, mësimdhënësve dhe nxënësve të kryhen me anë të telefonave dhe kompjuterave (desktop, laptop), nëpërmjet bisedave e mesazheve, duke përdorur ato programe që janë në përdorim masiv, kanë akses të lartë, sigurojnë shpejtësi shkëmbimi, ngarkojnë sa më pak memorjet e pajisjeve dhe kanë kosto sa më të ulët.
- Nga përvoja e deritanishme ka rezultuar që përdorimi i “grupeve në whatsapp” (çdo mësues, sipas klasave dhe lëndëve/moduleve) të jetë mjaft efektiv, por sipas rastit, rekomandohet të përdoren dhe mjedise të tjera (pa pagesë) për komunikiminjo-sinkron ose sinkron (më interaktiv) në grup, si e-mail, messenger, facebook, skype, zoom, virtual classroom, goole classroom, webinar etj.
- Mësuesit e TIK në çdo shkollë të kontribuojnë për përcaktimin e mënyrës/programit të komunikimit më efektiv për shkollën e tyre dhe të udhëzojnë mësuesit e tjerë për përdorimin e tij.
- Mësuesit kujdestarë të çdo klase të bëjnë koordinimin e mësuesve dhe instruktorëve që angazhohen në klasat përkatëse.
- Të zbatohet orari shkollës (dhe i klasës) ashtu siç ishte para ndërprerjes së mësimin në shkollë; orari i fillimit të mësimin mund të jetë fleksibël dhe të përcaktohet nga drejtoria e shkollës).
- Të zbatohen planet e mësimdhënies së lëndëve profesionale dhe moduleve profesionale të hartuara nga mësimdhënësit përkatës dhe të miratuara nga drejtoria.
- Të gjithë mësimdhënësit të krijojnë “regjistrin informal” (në letër apo në format elektronik tabelar) dhe për çdo lëndë/modul/klasë të mbajnë shënim çështjet/veprimtaritë mësimore të trajtuara, datat përkatëse, frekuentimin, rezultatet e vlerësimit të çdo nxënësi dheshënime të tjera; këto të shërbejnë si bazë për plotësimin e regjistrit dhe dokumentacionit formal me rikthimin e situatës normale të mësimin.

- Mësimdhënësit të informojnë rregullisht, në fund të çdo jave, drejtuesit e shkollës si dhe t'i kontaktojnë ata në çdo rast kur kanë paqartësi apo hasin problematika gjatë zbatimit.
- Mësimdhënësit e çdo lënde/moduli të informojnë, në fund të çdo jave mësuesin kujdestar të klasës përkatëse për ecurinë e mësimit dhe për çdo problematikë që ka të bëjë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin e mësimit në kushtet e shtëpisë.
- Mësuesit kujdestarë të informojnë, në fund të çdo jave drejtuesit e shkollës në lidhje me ecurinë dhe problematikat e mësimit në kushtet e shtëpisë, të klasës përkatëse.
- Mësuesit kujdestarë të mbajnë kontakte të vazhdueshme me nxënësit dhe me prindërit e tyre, të japin fedback, të evidentojnë problematikat dhe të gjejnë mënyra për angazhimin aktiv të të gjithë nxënësve në mësim.
- Në ato raste kur ka pamundësi të trajtimit të moduleve thellësisht praktike në kushtet e mësimit në shtëpi, drejtoritë e shkollave të përshtasin orarin e mësimit të klasave, duke shtuar orët javore të lëndëve teorike profesionale (dhe të përgjithshme) dhe duke pakësuar orët e moduleve praktike, për të krijuar hapësirë për trajtimin intensiv të këtyre moduleve, sapo të rikthehet situata normale e mësimit.
- Për nxënësit që, për arsye të ndryshme, e kanë patur të pamundur të angazhohen në mësimin online, drejtoritë e shkollës dhe mësimdhënësit, me rikthimin e mësimit në kushte normale, të planifikojnë dhe realizojnë seanca të veçanta mësimore teorike dhe praktike, ku të bëhet dhe vlerësimi i këtyre nxënësve

1. Në lidhje me Mësimin e lëndëve/moduleve profesionale, në kushtet e shtëpisë:

a) Për Lëndët teorike profesionale (në kushtet e mungesë së teksteve mësimore përkatëse):

- Mësuesi i lëndës, duke respektuar orarin e klasës përkatëse dhe në zbatim të planit të mësimdhënies përkatëse, të parapërgatitet për dokumentet (materialet) që do t'i transmetojë (si dokumente ose me foto) grupit të nxënësve të klasës.
- Për çdo njësi mësimore teorike (zakonisht 1 ose 2 orëshe), sipas planit të miratuar të mësimdhënies të kësaj lënde, mësuesi të përgatitënjë set dokumentesh, si më poshtë:
- (i) "Plan-ditarin" e kësaj njësie mësimore, i cili përgjithësisht, në mënyrë të përmbledhur (jo më shumë se një faqe A4) përmban: Emrin e mësuesit, klasën, lëndën dhe datën; Emërtimin dhe qëllimin e temës së kësaj njësie mësimore; Çështjet kryesore të kësaj teme; Indikacione për gjetjen e materialeve mësimore mbështetëse dhe udhëzime për analizimin e tyre; Detyrat që u jepen nxënësve (individuale apo në grupe); Mënyrën e vlerësimit të nxënësve.

- (ii) Materialet mësimore mbështetëse sintetike, me njohuritë kyçe për çdo çështje të kësaj njësie mësimore. Këto mund të jenë: materiale të përgatitura nga vetë mësuesi (tekste të shkurtëra, skema, diagrama, fotografi, procedura pune, shembuj, prezantime në ppt, fletë detyrash etj.); materiale të marra nga interneti (tekste të shkurtëra, skema, diagrama, fotografi, shembuj, prezantime, video mësimore etj.); adresa interneti ku nxënësit shkarkojnë materiale (materialet mësimore të AKAFPK dhe të Al-Tour në www.akafp.gov.al , platforma e S4J mesoVET.al, platforma në facebook si “Shkëmbim AFP” etj.).
- (iii) Instrumentet e vlerësimit të nxënësve (teste, ushtrime, fletë detyrash, mini-projekte etj.).
- Mësuesi i lëndës t’i transmetojë dokumentet e mësipërme (me attach ose me foto) gjithë grupit të nxënësve të klasës, pak përpara se të fillojë seancën e mësimit online, sipas orarit.
- Për shkak të kushteve të veçanta dhe natyrave shumë të ndryshme të qindra lëndëve profesionale në arsimin profesional, është e pamundur të rekomandohen metoda mësimore specifike për secilën prej tyre, në kushtet e mësimit online.
- Mësuesit të jenë kërkues, krijues dhe fleksibël për të përdorur mënyra, programe dhe metodologji mësimore të përshtatshme për kushtet e krijuara. Nëse e mundëson natyra e lëndëve të veçanta, p.sh., të drejtimit TIK apo Ekonomi biznes, si dhe kur zotërojnë teknologjinë përkatëse, mësuesit të organizojnë mësim interaktiv online, në ngjashmëri me atë që realizojnë në klasë.
- Nëse e lejojnë kushtet, rekomandohet të përdoret edhe metoda e punës me ndarjen e klasës në disa nën-grupe, të cilat komunikojnë jo vetëm me mësuesin, por edhe midis tyre, veçanërisht për realizimin e detyrave të veçanta.
- Gjatë mësimit me komunikim sinkron, mësuesit jo vetëm të japin shpjegime dhe udhëzime, por edhe t’i krijojnë mundësi nxënësve që të pyesin dhe të kërkojnë shpjegime.
- Nëse e lejojnë kushtet, mësuesit të përdorin metoda tërheqëse dhe argëtuese për mësimin (teza për diskutim, debate, konkurse etj.).
- Rekomandohet që nxënësit të mos mbingarkohen me informacione dhe detyra që t’i jepet më shumë mundësi punës së tyre të pavarur, hulumtuese dhe krijuese.
- Rekomandohet që, bazuar në Programet orientuese të provimeve të Teorisë Profesionale të Integruar të Maturës Shtetërore Profesionale dhe provimeve të Niveleve, edhe gjatë trajtimit online të lëndëve profesionale, të vihet theksi te kërkesat e këtyre programeve.
- Mësuesit e drejtimeve/profileve dhe lëndëve profesionale të njëjta, që ofrohen në shkollat të ndryshme të vendit, të komunikojnë dhe të krijojnë rrjete profesionale për të shkëmbyer përvoja, metodologji dhe materiale mësimore.

b) Për Modulet praktike profesionale (në kushtet e mungesë së mjediseve e mjeteve për realizimin e praktikave profesionale):

- Meqenëse modulet e praktikave profesionale janë me natyra shumë të ndryshme, kërkojnë kushte shumë të veçanta dhe përgjithësisht kanë procedurë pune të pazbatueshme në kushtet e shtëpisë, rekomandohet që çdo instruktor, të analizojë me kujdes modulin, rezultatet mësimore dhe kriteret e vlerësimit përkatëse, si dhe të përcaktojë ato procedurë pune që mund të mbështeten me ilustrime, shembuj demonstrimesh dhe shpjegime me anë të udhëzimeve dhe materialeve mësimore mbështetëse.
- Pas kësaj analize të modulit praktik, procedurat e punës të përzgjedhura të trajtohen në mënyrë të ngjashme si edhe të lëndët teorike profesionale.
- Instruktori të rishikojë planin e mëparshëm të mësimdhënies së modulit, ta përshtasë atë duke konsideruar analizën e kryer më parë dhe të përcaktojë njësitë mësimore përkatëse.
- Instruktori i modulit praktik, duke respektuar orarin e klasës përkatëse, për çdo njësi mësimore “praktike” (zakonisht 1 - 3 orëshe) pasi ka përzgjedhur ato procedurë pune që mund të trajtohen online, parapërgatit një set dokumentesh (materialesh) që do i transmetojë grupit të nxënësve të klasës, si më poshtë:
 - (i) “Plan-ditarin” e kësaj njësie mësimore “praktike”, i cili përgjithësisht, në mënyrë të përmbledhur (jo më shumë se një faqe A4) përmban: Emrin e instruktorit, klasën, modulin, rezultatin mësimor dhe datën; Emërtimin dhe qëllimin e procedurave të përzgjedhura për këtë njësi mësimore; Indikacione për gjetjen e materialeve mësimore përkatëse dhe udhëzime për analizimin e tyre; Detyrat që u jepen nxënësve (individuale apo në grupe); Mënyrën e vlerësimit të nxënësve.
 - (ii) Materialet mësimore mbështetëse sintetike që trajtojnë aspektet kyçe të procedurave që përmban çdo njësi mësimore. Këto mund të jenë: materiale të përgatitura nga vetë instruktori (prezantime në ppt, video demonstruese, udhëzues të procedurave të punës, fletë detyrash, rregulla të sigurisë, higjënës mbrojtjes së mjedisit, ilustrime, skema, diagrama, fotografi, shembuj të produktit etj.); si këto materiale por të marra nga interneti, veçanërisht video mësimore demonstruese; adresa interneti ku nxënësit të shkarkojnë materiale (materialet mësimore të AKAFPK dhe AI-Tour në www.akafp.gov.al , platforma e S4J mesoVET.al, platforma në facebook si “Shkëmbim AFP” etj.).
 - (iii) Instrumentet e vlerësimit të nxënësve (teste, ushtrime, detyra, mini-projekte etj.).

- Instruktori i modulit t'i transmetojë dokumentet e mësipërme (me attach ose me foto) gjithë grupit të nxënësve të klasës, pak përpara se të fillojë seancën e mësimit online, sipas orarit.
- Për shkak të kushteve të veçanta dhe natyrave shumë të ndryshme të rreth dymijë moduleve profesionale në drejtimet/profilet e arsimit profesional, është e pamundur të rekomandohen metoda mësimore specifike për secilin prej tyre, në kushtet e mësimit online.
- Instruktorët e praktikës të jenë kërkues, krijues dhe fleksibël për të përdorur mënyra, programe dhe metodologji mësimore të përshtatshme për trajtimin e moduleve në kushtet e krijuara. Nëse e mundëson natyra e moduleve të veçanta, si dhe kur zotërojnë teknologjinë përkatëse, instruktorët të organizojnë mësim interaktiv online.
- Në drejtime/profile profesionale të caktuara, p.sh. TIK apo Ekonomi biznes (firma ushtrimore), instruktorët kanë mundësi që, në kushte shtëpie, të realizojnë module praktike të caktuara në mënyrë të përafërt me atë që do të realizonin në shkollë.
- Module të caktuara të bujqësisë, kopshtarisë, kuzhinës, rrobaqësisë, riparimeve elektroshtëpiake, TIK-ut, SHMT-së etj., rekomadohet të përshtaten nga instruktorët përkatës dhe, ata nxënës që i kanë kushtet, udhëzohen që t'i realizojnë në shtëpitë, oborret, kopshtet dhe mjediset ku ata banojnë, duke përdorur pajisjet dhe veglat që kanë aty.
- Nëse e lejojnë kushtet, rekomandohet të përdoret edhe metoda e punës me ndarjen e klasës në disa nën-grupe, të cilat komunikojnë jo vetëm me instruktorin, por edhe midis tyre, veçanërisht për realizimin e detyrave të veçanta.
- Gjatë mësimit me komunikim sinkron, mësuesit jo vetëm të japin shpjegime dhe udhëzime, por edhe t'i krijojnë mundësi nxënësve që të pyesin dhe të kërkojnë shpjegime për procedurat që kryhen dhe produktet që krijohen.
- Rekomandohet që, bazuar në Programet orientuese të provimeve të Praktikës Profesionale të Integruar të Niveleve, edhe gjatë trajtimit online të moduleve profesionale të vihet theksi te kërkesat e këtyre programeve.
- Instruktorët e moduleve praktike duhet të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me mësuesit e lëndëve profesionale të drejtimit përkatës, për të shkëmbyerpërvoja, metodologji dhe materiale mësimore.
- Instruktorët e drejtimeve/profilevedhe moduleve profesionale të njëjta, që ofrohen në shkolla të ndryshme të vendit, të komunikojnë dhe të krijojnë rrjete profesionale për të shkëmbyer përvoja, metodologji dhe materiale mësimore.

2. Në lidhje me Vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor në kushtet e shtëpisë:

- Mësuesit e lëndëve profesionale dhe instruktorët e moduleve profesionale e planifikojnë dhe e zbatojnë vlerësimin e nxënësve në kushtet e mësimit online, për çdo njësi mësimore (teorike ose “praktike”) duke u bazuar në “plan ditarin” përkatës.
- Format kryesore të vlerësimit të nxënësve, ashtu sikurse gjatë mësimit në shkollë, do të jenë “vlerësimi i vazhduar (VV)” dhe “vlerësimi përmbledhës (VP)”. Vlerësimi përfundimtar vjetor (VPV) për lëndën ose modulën do të jetë me formulën: $VPV = 0,4 \text{ Mesatares së VV} + 0,6 \text{ Mesatares së VP}$. Sigurisht që për llogaritjen e mesatareve do të konsiderohen notat e mëparshme të mësimit në shkollë dhe notat e mësimit në kushtet e shtëpisë.
- Mësuesit dhe instruktorët të përcaktojnë dhe të përgatitin “instrumentet e vlerësimit” që do të përdorin gjatë realizimit të mësimit online të njësisë mësimore përkatëse.
- Mësuesit dhe instruktorët të përzgjedhin, hartojnë dhe përdorin ato instrumente të vlerësimit që konsiderojnë përmbajtjen e njësisë mësimore që do realizohet online, detyrat që jepen, numrin e nxënësve dhe mënyrën si do realizohet mësimi online (me komunikim sinkron apo josinkron).
- Instrumentet kryesore të vlerësimit të jenë pyetjet me gojë, të hapura dhe të mbyllura (gjatë komunikimit me zë), pyetjet me shkrim të hapura (ese), pyetje me shkrim të mbyllura (me alternativa, me PO-JO, me plotësim, me kombinim), testet komplekse me shkrim, kontrolli i detyrave të kryera (ushtrime, skica, problema), kuize, listë kontrolli, rubrika vlerësimi.
- Nëse e lejojnë kushtet, mësimdhënësit të përdorin për vlerësimin e nxënësve edhe veprimtari tërheqëse dhe argëtuese të tilla si hedhja e tezave për diskutim, debatet, konkurse etj.
- Në rastin e testeve me shkrim, mësimdhënësit të përgatitin vetë të tilla ose t'i referohen bankave të testeve të publikuara faqen e AKAFPK (www.akafp.gov.al).
- Nëse janë kushtet e duhura, mësimdhënësit të përdorin programe të posaçme testimi online me klasa të veçanta (p.sh., të drejtimit të TIK) dhe të bëjnë vlerësimin e menjëhershëm të nxënësve.
- Mësuesit e lëndëve teorike profesionale të bashkëpunojnë që të përgatisin teste të teorisë profesionale të integruar, të ngjashme me formatin e provimeve të Maturës dhe të Niveleve, për të bërë parapërgatitjen e nxënësve me këto provime.
- Gjatë komunikimit online edhe me figurë, të konsiderohet edhe lista e kontrollit për veprimet e kryera nga nxënësit.
- Në rastet e veçanta kur nxënësit i kanë mundësitë të kryejnë procedurë praktike në kushtet e mjediseve të banimit (në TIK, bujqësi, kopshtari, kuzhinë, rrobaqepsi, SHMT etj.), instruktori i praktikës të mbikqyrë drejtpërdrejt dhe të vlerësojë me listë kontrolli veprimet e tyre. Në rastet

e pamundësisë së mbikqyrjes së drejtpërdrejtë, nxënësit mund të filmojnë vetë dhe t'i dërgojnë instruktorit videon e procesit dhe/ose fotot e produktit të punës.

- Përgjithësisht, nxënësit plotësojnë testet apo detyrat e dhëna në format elektronik ose në letër. Nëse i plotësojnë në letër (fletore ose format A4), nxënësit i fotografojnë detyrat dhe i'a dërgojnë mësimdhënësit përkatës.
- Mësimdhënësit vlerësojnë (përgjithësisht jo drejtpërdrejt) detyrat dhe testet e plotësuara që i marrin online nga nxënësit, t'i njoftojnë menjëherë ata për rezultatet e vlerësimit, si dhe të plotësojnë tabelat e notave për çdo klasë (në format elektronik ose format letre).
- Mësimdhënësit të informojnë paraprakisht nxënësit për detyrat/testet që do të kryejnë, afatet kohore, kriteret e vlerësimit dhe skemën e konvertimit me notë.
- Në rastet e vlerësimit/testimit online në grup, mësimdhënësi të sigurohet që në seancë po marrin pjesë të gjithë nxënësit dhe janë në kushte të përshtatshme komunikimi.
- Nxënësit që dështojnë në përgjigjet e para, të motivohen dhe të mbështeten që të tentojnë përsëri dhe të përmbushin me sukses detyrat e dhëna.
- Mësimdhënësit të nxitin nxënësit që të kryejnë edhe vetvlerësime të detyrave, testeve dhe punimeve që ata kryejnë.
- Për të ulur fiktivitetin e vlerësimit (nxënësit mund t'i marrin përgjigjet e zgjidhjet nga njëri-tjetri ose nga familjarët), mësimdhënësit të bëjnë pyetje dhe të japin detyra individuale ose në grupe të vogla për nxënësit. Gjithashtu, në rast të pyetjeve e detyrave të njëjta për të gjithë klasën, të kërkohet një kohë e caktuar për kthimin e përgjigjes, gjatë seancës së mësimi online.
- Nxënësve t'u kërkohet që të krijojnë "portofolet e vlerësimit" individual ku të ruajnë të gjitha testet e plotësuara dhe detyrat e kryera, të cilat mund të shërbejnë për vlerësime në të ardhmen.
- Rekomandohet që nxënësit të mos mbingarkohen me vlerësime (detyra, teste, ushtrime) në mënyrë që t'i jepet më shumë mundësi punës së tyre të pavarur.
- Mësimdhënësit të ruajnë të gjithë dokumentacionin e rezultateve të vlerësimit të nxënësve në format elektronik ose në format letre (do të përdoret në vijim për plotësimin e regjistrave dhe vlerësimin përfundimtar).
- Përsa i përket organizimit dhe vlerësimit për Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale dhe Provimet e Niveleve, nëse do të kryhen jo në kushtet normale, do të jepen udhëzime të posaçme në kohën e duhur.

Në situatën e krijuar, realizimi i procesit mësimor teorik dhe praktik, si dhe i vlerësimit të nxënësve në kushtet e shtëpisë është një sfidë e vështirë por e rëndësishme për Arsimin Profesional, për të mundësuar vijimësinë e përgatitjes profesionale të nxënësve me cilësi optimale dhe me kërkesat e tregut të punës. Kjo kërkon mobilizimin dhe përkushtimin e stafit drejtues dhe mësimdhënës të shkollave profesionale për tu përshtatur me kushtet e krijuara.

Në vijim tregohen **adresa Interneti** që ofrojnë informacione dhe materiale të dobishme për mësimdhënësit dhe nxënësit, për mësimin në kushtet e shtëpisë në Arsimin Profesional:

Nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve:

- Skeletkurrikulat e AP në linkun e mëposhtëm:
<http://www.akafp.gov.al/dokumente-kurrikulare/skelet-kurrikula-te-arsimit-te-mesem-profesional/>
- Materiale mësimore mbështetëse për lëndët profesionale, nga AKAFP dhe modulet profesionale të Hotelieri turizmit, nga AI-Tour, në linkun e mëposhtëm:
<http://www.akafp.gov.al/dokumente-kurrikulare/materiale-mesimore/>
- Programet orientuese të provimeve përfundimtare, sipas niveleve, në linkun e mëposhtëm:
<http://www.akafp.gov.al/programe-orientuese/>
- Programet orientuese të maturës shtetërore profesionale 2020, për Teorinë Profesionale të Integruar, në linkun e mëposhtëm:
<http://www.akafp.gov.al/vleresimi-dhe-certifikimi/programe-orientuese-matura-shteterore-profesionale/>
- Banka testesh për kualifikimet profesionale, në linkun e mëposhtëm:
<http://www.akafp.gov.al/vleresimi-dhe-certifikimi/banka-testesh-per-provimet-e-niveleve/>

Nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar:

- Programi orientues i maturës shtetërore profesionale, për lëndën Gjuhë e huaj në linkun e mëposhtëm:
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/10/Gjuhe-e-huaj.pdf>
- Programi orientues i maturës shtetërore profesionale, për lëndën Matematikë në linkun e mëposhtëm:
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/10/Matematike-12.pdf>
- Programi orientues i maturës shtetërore profesionale, për lëndën Gjuhë shqipe dhe Letërsi në linkun e mëposhtëm:
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/10/Gjuhe-shqipe-dhe-letersi-1.pdf>

Nga Qendra e Shërbimeve Arsimore:

- Matura Shtetërore Gjuha Shqipe dhe Letërsia, në linkun e mëposhtëm:
http://www.qsha.gov.al/infos/gjuhe_shqipe.pdf
- Matura Shtetërore 2019, teste dhe skema vlerësimi, gjuhët e huaja, matematika dhe lëndë me zgjedhje (për gjimnazin) në linkun e mëposhtëm:
http://www.qsha.gov.al/infos/matematike_lende_zgjedhje_gjuhe_huaj.pdf

Platforma online: mesoVET.al, me larmi informacionesh dhe materiale mësimore mbështetëse sipas lëndëve dhe moduleve profesionale për drejtimet “Ekonomi –biznes” dhe “Hoteleri-turizëm”

Rrjeti profesional në Facebook: [Shkëmbim AFP](#) me informacione dhe materiale mësimore mbështetëse për Drejtimet “Hoteleri-turizëm”, “Instalues termohidraulik” dhe “Ekonomi-biznes”.

PUNË TË MBARE!